


Shëndeti juaj, siguria juaj

Një udhëzues i shkurtër për punëtorët

Albanian



This is an **Albanian** version of leaflet INDG450, published 10/12

Hyrja

Ky informacion është ofruar nga Ekzekutivi i Shëndetit dhe Sigurisë (ESHS) në bashkëpunim me Kongresin e Sindikatave (KS). ESHS-ja punon për të mbrojtur shëndetin, sigurinë dhe mirëqenien e punëtorëve duke zbatuar ligjin mbi shëndetin dhe sigurinë e duke ofruar këshilla dhe mbështetje. KS-ja përfaqëson 55 sindikata me më shumë se gjashtë milionë anëtarë. Ajo lufton për drejtësi dhe standarde të mira në punë.

Nëse jeni i punësuar (me kohë të plotë ose të pjesshme, i përkohshëm ose i përhershëm), ky informacion shpjegon se cilat janë të drejtat tuaja, çfarë duhet të prisni nga punëdhënësi juaj, çfarë përgjegjësisish keni dhe ku duhet të shkoni për ndihmë.

Kjo aplikohet edhe nëse jeni një i ri e po përfitoni eksperiencë pune, një stazhier, një punonjës në lëvizje ose punonjës në shtëpi ose punonjës migrant (edhe nëse po punoni në MB pa leje).

Nëse jeni punëtor i përkohshëm, i rastësishëm ose nga një agjenci, agjencia juaj, rekrutuesi i punëtorëve ose kontraktori duhet të bashkëpunojë dhe të komunikojë me biznesin që po përdor shërbimin tuaj, për t'u siguruar që shëndeti dhe siguria juaj po menaxhohen në mënyrë efikase.

Nëse jeni vullnetar dhe dëshironi informacion të mëtejshëm mbi shëndetin dhe sigurinë tuaj, vizitoni www.hse.gov.uk/voluntary/index.htm.

Shëndeti juaj, siguria juaj

Ju keni të drejtën:

- të punoni në vende ku të gjitha rreziqet ndaj shëndetit dhe sigurisë tuaj janë të kontrolluara siç duhet;
- të mos punoni dhe të largoheni nga vendi i punës nëse mendoni se ndodheni nën rrezik;
- të informoni punëdhënësin tuaj rreth çështjeve dhe shqetësimeve mbi shëndetin dhe sigurinë;
- të kontaktoni ESHS-në ose autoritetin tuaj vendor, nëse ende keni shqetësime mbi shëndetin dhe sigurinë, pa pasur probleme;
- të anëtarësoheni në një sindikatë dhe të bëheni përfaqësues i sigurisë;
- të merrni kohë të lirë të paguar për trajnim nëse jeni përfaqësues i sigurisë;

- të bëni një pushim për të paktën 20 minuta nëse punoni më shumë se gjashtë orë rresht dhe të keni të drejtën të merrni lejen e zakonshme vjetore të paguar;
- të keni banja, vende për t'u larë dhe ujë të pijshëm.
- të keni vende të përshtatshme për ndihmën e shpejtë.

Ju duhet:

- të bëni kujdes për shëndetin dhe sigurinë tuaj dhe atë të personave që mund të ndikohen nga ajo që bëni (ose nuk bëni) ju;
- të bashkëpunoni me të tjerë për shëndetin dhe sigurinë, dhe të mos ndërhyni ose të mos keqpërdorni asgjë nga ato që janë dhënë për shëndetin, sigurinë dhe mirëqenien tuaj;
- të ndiqni trajnimin që keni marrë kur përdorni ndonjë send pune që jua ka dhënë punëdhënësi juaj.

Përgjegjësitë e punëdhënësit

Punëdhënësi juaj duhet:

- t'ju thotë në një mënyrë të kuptueshme se si ta bëni punën pa rrezikuar, dhe t'ju thotë rreth rreziqeve ndaj shëndetit dhe sigurisë nga praktika aktuale ose të propozuara të punës.
- t'ju thotë se si do të kontrollohet ndonjë rrezik dhe kush është përgjegjës për të;
- të konsultohet dhe të punojë me përfaqësues të shëndetit e sigurisë dhe punonjësit për t'i mbrojtur të gjithë nga rreziku në vendin e punës;
- t'ju thotë se si të merrni trajtim të ndihmës të parë dhe çfarë duhet të bëni në rast emergjence.

Punëdhënësi juaj duhet që t'ju japë pa pagesë:

- trajnim për t'ju mundësuar që ta bëni punën në mënyrë të sigurt;
- çdo pajisje dhe mbrojtje të nevojshme për ju në punë (të tilla si veshje, këpucë ose çizme, mbrojtje për sytë dhe veshët, doreza, maska, etj) dhe të sigurohet kujdesia për to të jetë e përshtatshme;
- kontrole të shëndetit nëse ka rrezikshmëri të problemeve shëndetësore për shkak të punës tuaj;
- kontrole të rregullta të shëndetit nëse punoni natën dhe një kontroll përpara se të filloni.

Shënim: Nëse vërtetë jeni të vetë-punësuar, jeni ju përgjegjës për të organizuar ndihmën e parë, trajnimin, pajisjet mbrojtëse dhe kontrole e shëndetit për veten, si dhe për të organizuar kohën tuaj të punës.

Punëdhënësi juaj duhet t'ju ofrojë informacionin e mëposhtëm:

- afishen mbi shëndetin dhe sigurinë (www.hse.gov.uk/pubns/books/lawposter.htm), e cila duhet vendosur në një vend të dukshëm, ose si alternativë, ata mund t'ju japin secilit punëtor një kopje ekuivalente të kartës

së xhepit. Në të duhen të jenë të dhënat e kontaktit të personave që mund të ndihmojnë;

- deklaratën e politikës së tyre mbi shëndetin dhe sigurinë;
- një certifikatë të përditësuar të Përgjegjësisë së Punëdhënësit (Sigurimi i Detyruar) (www.hse.gov.uk/pubns/hse40.pdf) që të jetë afishuar dukshëm në vendin tuaj të punës.

Çfarë duhet bërë nëse keni shqetësime mbi shëndetin dhe sigurinë tuaj

Për këshilla, vizitoni www.hse.gov.uk/workers/index.htm, ose për t'u ankuar vizitoni www.hse.gov.uk.

Për të drejtat e të punësuarit, vizitoni faqen e internetit workSMART të Kongresit të Sindikatave në www.worksmart.org.uk, ose përndryshe mund të telefononi Linjën e Ndihmës për të Drejtat e Pagës dhe Punës në 0800 9172 368.

Për informacion rreth shëndetit dhe sigurisë në një numër të ndryshëm gjuhësh, vizitoni www.hse.gov.uk/migrantworkers/index.htm.

Nëse keni humbur punën për shkak të një çështjeje që ka të bëjë me shëndetin dhe sigurinë, mund t'ju duhet të ankoheni te një Gjykatë e Punësimit. Pyesni sindikatën tuaj ose Zyrën e Këshillimit të Qytetarëve për këshilla.

Informacion i mëtejshëm

Për informacion rreth shëndetit dhe sigurisë, ose për të raportuar mospërputhje ose pasaktësi në këtë udhëzues, www.hse.gov.uk/

Ky udhëzues është lëshuar nga Ekzekutivi i Shëndetit dhe Sigurisë. Ndjekja e udhëzimeve nuk është e detyrueshme, përveçse kur është specifikuar ndryshe, dhe ju jeni të lirë të ndërmerrni veprime të tjera. Por nëse i ndiqni udhëzimet normalisht duhet të keni bërë mjaft për të qenë në pajtueshmëri me ligjin. Inspektorët e shëndetit dhe sigurisë kërkojnë të sigurojnë pajtueshmëri me ligjin dhe mund t'i referohen këtij udhëzuesi.

Fletëpalosja mund të gjendet në www.hse.gov.uk/pubns/indg450A.htm.

© *Crown copyright* Nëse dëshironi ta përdorini sërish këtë informacion vizitoni www.hse.gov.uk/copyright.htm për hollësi. Botuar për herë të parë 10/12.